



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 27.03.2025
Numër Protokolli: 2125/2025

A.nr. 83/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.83/2025 të datës 14.01.2024 të parashtruar nga ankuesi S.A, kundër organit të punësimit Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen juridike “*Kontestim Konkursi*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin dhe 1.3 dhe nën paragrafi 1.1 të Ligjit r. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.83/2025, e datë 14.01.2025, e parashtruar nga ankuesi S.A, për pozitën Inspektor i Arsimit SIA Gjakovë në atë mënyrë që aprovohet pretendimi lidhur me shkelje procedurale, ndërsa, refuzohet pretendimet tjera si në ankesë, ndërsa **refuzohet si e pabazuar** ankesa për pozitën Inspektor i Arsimit SIA Prizren.

II. Ndryshohet Njoftimi me numër protokolli 3691, i datës 14.12.2024, i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtar, në procedurën e pranimit më numër të referencës RN00013763, grupi i arsimit pozita Inspektor i Arsimit-SIA Gjakovë, si dhe Njoftimi i datës 30.10.2024, i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit lidhur me fazën e verifikimit paraprak, ashtu që, kandidatja A.K, largohet nga lista e kandidatëve fitues si dhe nga lista e kandidateve që kanë plotësuar kriteret në verifikimin paraprak, ndërsa, pjesa tjetër e Njoftimit me numër protokolli 3691, të datës 14.12.2024 si dhe Njoftimit të datës 30.10.2024 për verifikim paraprak mbesin të pandryshuara. **Mbetet në fuqi** Njoftimi Nr.3689 i datës 14.12.2024, i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtar, në procedurën e pranimit me numër të referencës RN00013761.

III. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 28.10.2024, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, lidhur me refuzimin aplikacionit të ankuesit.

IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjithë veprimet e nevojshme administrative, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, ashtu siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit.

V. Obligohet Divizioni i Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, që në procesin e verifikimit përfundimtar para emërimit sipas nenit 14 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, në atë mënyrë që të sigurohen dëshmi përkatëse se kandidatët fitues të mos kenë ushtruar funksione politike në 3 (tre) vitet e fundit.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, S.A (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 14.01.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 14.12.2024, lidhur me procedurën e pranimi RN00013763 dhe njoftimit të datës 14.12.2024, SIA Gjakovë lidhur me procedurën e pranimi dhe RN00013761-SIA Prizren , të shpallura nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.01.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit (*në tekstin e mëtejme referuar: MASHTI*), ndërsa kjo e fundit, më datë 07.02.2025 ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 149/2025 të datës 14.01.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e letërnjoftimit; Kopja e konkursit me nr.ref.RN00013761-SIA në Prizren; Kopja e konkursit me nr.ref.RN00013763-SIA në Gjakovë; Njoftimi i datës 14.12.2024 për shpalljen e kandidatëve fitues në procedurën e konkursit RN00013761-SIA Prizren; Njoftimi i datës 14.12.2024 për shpalljen e kandidatëve fitues në procedurën e konkursit RN00013763-SIA Gjakovë; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 28.01.2025 dhe përgjigje në ankesë e datës 07.02.2025 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Lista e aplikantëve; Lista e kandidatëve Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.01.2025; Përgjigjen në kërkesë e datës

03.02.2025; Vendimin Ref.10/Nr.Prott.774 të datës 04.11.2024 dhe Vendimin Ref.10/Nr.Prot.785 të datës 05.11.2024 të u.d Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit për themelimin e Komisionit të Pranimit dhe Akt Emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit; Listën e aplikantëve të aprovuar datës 30.10.2024; Listën e përgjithshme të kandidatëve; Aplikacionin e ankuesit të datës 28.04.2024 me dokumentacionin e bashkangjitur prej 1-14 faqesh; Aplikacionin e kandidatit të suksesshëm B.P të datës 02.05.2024 me dokumentacionin e bashkangjitur prej 85 faqesh; Diplomën e datë 12.10.2013 me shifër Nr.2109; Diplomën e datës 18.07.2019 me shifër Nr.942; Vërtetimin Nr.83 të datës 30.04.2024; Aplikacionin e kandidatit të suksesshëm I.K të datës 11.04.2024 me dokumentacionin e bashkangjitur prej 1-46 faqesh; Diplomën e datë 24.10.2008 me shifër Nr.12-654-04/966; Vendimit të datës 21.01.2009 të Kryetarit të Komisionit Kombëtar për Njohje dhe U.D Sekretari i Përhershëm i MASHT-it; Diplomën e datës 24.03.2015 me shifër Nr.805; Akt Emërimin e datës 01.01.2012; Vërtetimit numër Reference:12/2021 të lëshuar nga Drejtori i Shkollës SHMLM “Lorenc Antoni”; Akt Emërimit AE.Nr.01-112-172224 të datës 29.10.2021; Formularët e vlerësimit Individual nga Komisioni i Pranimit për CN1989; Formularët e vlerësimit Individual nga Komisioni i Pranimit për CN0844; Formularët e vlerësimit Individual nga Komisioni i Pranimit për CN3768; Formularët e vlerësimit individual të Komisionit për kandidatin në intervistë i datës 06.12.2024; Lista përfundimtare e vlerësimit të kandidatëve; Formulari i renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 14.12.2024. Konkursin me numër të referencës RN00013763, grupi i arsimit pozita Inspektor i Arsimit në SIA Gjakovë; Kopjen e ID-së së ankuesit; Njoftimin e datës 28.10.2024 për refuzimin e aplikacionit të ankuesit; Njoftimin e datës 14.10.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 30.12.2024; Përgjigjen në ankesë e datës 16.01.2025; Vendimin Ref.10/Nr.Prott.774 të datës 04.11.2024 dhe Vendimin Ref.10/Nr.Prot.785 të datës 05.11.2024 të u.d Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit për themelimin e Komisionit të Pranimit dhe Akt Emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit; Listën e aplikantëve; Listën e verifikimit paraprak e datës 30.10.2024; Formularët e vlerësimit të eses datës 27.11.2024; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë për kandidatët fitues datës 06.12.2024; Njoftimin me numër protokolli 3691 të datës 14.12.2024 për kandidatët fitues; Aplikacionin e kandidatit M.D i datës 08.04.2024 me dokumentacionet nga faqe 1-93; Aplikacionin e kandidatit N.P i datës 02.05.2024 me dokumentacionet nga faqe 1-76; Aplikacionin e kandidatit A.L i datës 29.04.2024 me dokumentacionet nga faqe 1-23; Aplikacionin e kandidatit A.K i datës 26.04.2024 me dokumentacionet nga faqe 1-51; Aplikacionin e kandidatit M.F i datës 23.04.2024 me dokumentacionet nga faqe 1-40; Aplikacionin e kandidatit A.H i datës 26.04.2024 me dokumentacionet nga faqe 1-38; Aplikacionin e kandidatit K.R i datës 15.04.2024 me dokumentacionet nga faqe 1-75; Aplikacionin e kandidatit A.Zh i datës 28.04.2024 me dokumentacionet nga faqe 1-120; Plotësimin e përgjigjes në ankesë datë 05.02.2025 dhe Aplikacionin e ankuesit i datës 08.04.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-40.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, më datë 05.04.2024, ka shpallë konkursin publik me numër reference RN00013761, Grupi i arsimit, pozita Inspektor i Arsimit-SIA në Prizren , klasa Profesional 1, tri vende pune, ndërsa në këtë

konkurs kanë aplikuar shtatëdhjetë e tetë (78) kandidatë, ku tridhjetë e pesë (35) nga kandidatet ka hyrë në listën e ngushtë, duke përfshirë edhe ankuesin. si dhe konkursin publik me numër reference RN00013763 Grupi i arsimit, pozita Inspektor i Arsimit-SIA në Gjakovë , klasa Profesional 1, gjashtë vende pune, ndërsa në këtë konkurs kanë aplikuar shtatëdhjetë e tetë (78) kandidatë, ku tridhjetë e pesë (35) nga kandidatet ka hyrë në listën e ngushtë, duke përfshirë edhe ankuesin. të hapur për aplikim nga data 06.04.2024 deri më datën 05.05.2024.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi ka aplikuar në dy konkurset si më sipër, duke u përfshirë në listën e verifikimit paraprak si kandidatë që i ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale, dhe mbi këtë bazë i njëjti i është nënshtruar edhe fazës së vlerësimit të testit me shkrim me ç ‘rast në testin me shkrim për konkursin me numër reference RN00013761, pozita Inspektor i Arsimit-SIA Prizren , ka grumbulluar gjithsejtë 43 pikë, ndërsa në konkursin me numër reference RN00013763, pozita Inspektor i Arsimit-SIA Gjakovë, ka grumbulluar gjithsejtë 42 pikë, nga rrjedhë se ankuesi nuk ka arritur pikët e mjaftueshme për të vazhduar më fazën tjetër të vlerësimit, gjegjësisht vlerësimit të intervistës me gojë, të cilat nuk kanë qenë të mjaftueshme për të vazhduar tutje ne fazat tjera të rekrutimit sikurse përcaktohet edhe me dispozitat e nenit 9 paragrafi 4 dhe nenit 10 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil,

Tutje nga shkresat e lëndës rezulton së kjo procedurën e pranimit ka përfunduar me Njoftimin me numër protokolli 1269, të datës 24.07.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, lidhur më shpalljen e rezultateve përfundimtare, mirëpo pas ankesës së parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga kandidateje me inicialet V.H, Këshilli më Vendimin A.nr.1178/2024 të datës 14.09.2204, ka aprovuar ankesën e palës ankuese ka anuluar Njoftimin me numër protokolli 1269, të datës 24.07.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, lidhur më shpalljen e rezultateve përfundimtare si dhe çdo veprim tjetër deri në fazën e verifikimit paraprak, duke obliguar Njësinë e Burimeve Njerëzore të MASHTI që të rihvilloj procedurën e pranimit për këtë pozitë nga faza e verifikimit paraprak.

Tutje në zbatim të vendimit të Këshillit, më datë 14.10.2024, Divizioni i Burimeve Njerëzore i MASHTI, ka publikuar njoftimin dhe njëkohësisht ka njoftuar të gjithë kandidatet në këtë procedurë lidhur me rivlerësimin e dokumentacionit në verifikimi paraprak, ndërsa ne kuadër të këtij veprimi Njësia e Personelit përmes Njoftimit të datës 28.10.2024, ka refuzuar aplikacionin e ankuesit më arsyetimin se dëshmia që se nuk keni në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë disiplinore në institucione publike është lëshuar në vitin 2023.

Pas përfundimit të procedurës së vlerësimit profesional, Njësia e Personelit më datë 14.12.2024 ka publikuar Njoftimi me numër protokolli 3691, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për pozitën *Inspektor i Arsimit SIA Gjakovë*, ku si rrjedhojë si kandidatë fitues kanë rezultuar shtatë kandidatë: M.D më 89 pikë, N.P më 87.6 pikë, A.L më 85.6 pikë, A.K më 82.4 pikë, M.F më 81.4 pikë, A.H më 79.6 pikë, K.R më 78.8 pikë dhe A.ZH me 72.2 pikë. ndërsa sipas Njoftimit Nr.3689 të datës 14.12.2024 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për shpalljen e rezultateve përfundimtare për pozitën

Inspektor i Arsimit SIAPrizren, rezulton se kjo procedurë ka dy kandidatë të suksesshëm, kandidati B.P me gjithsejtë 93.2 pikë dhe kandidati I.K me gjithsejtë pikë 82.8, kundër të cilit njoftim ankuesi me datë 14.01.2025 ka parashtruar ankesë në Këshill.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin konteston fazën e testimit me shkrim dhe kërkon rivlerësimin e konkursit me nr.ref.RN00013761 dhe konkursin me nr.ref RN00013763 të shpallur me datë 05.04.2024.

Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i aktit të shpalljes së konkursit më numër të referencës: RN00013763, ka gjetur se si kriteret të përgjithshme formale, lidhur me këtë pozitë janë përcaktuar: *Të kenë së paku titull master (300 ECTS), Të kenë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në fushën e arsimit dhe Të mos kenë ushtruar funksione politike në 3 (tri) vitet e fundit*, ndërsa tek pika 5 e konkursit lidhur me dokumentet që duhet dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre është kërkuar: *Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës; Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; Kopjen e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimi për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë së punësimi jashtë institucioneve publike duhet të mbështete se paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale; Kopjen e certifikatave të trajnimeve; Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rënda në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucione publike”.*

- Kolegji i Këshillit lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, ju referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

-Nenit 9 paragrafi 1: *“1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t’i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t’u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojnë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj”*

-Nenit 39 ku përcaktohet: 1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të

përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së..... 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit....”

Në kontekst të kriterëve specifike të përcaktuara për pozitën e shpallur, Inspektor i Arsimit, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore të nenit 9 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: **2. Përfshirja, për pozita specifike të zyrtarëve publikë, mund të kërkojnë kriterë specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike.**

Po ashtu, Kolegji i Këshillit mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, me theks të veçantë:

-Nenin 19 : Kërkesat e përgjithshme formale, përfshijnë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës që janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi.

-Nenin 20 :1. Kriteret specifike, për pozita të caktuara, mundet të përcaktohen vetëm gjatë procesit të miratimit të përshkrimit të vendit të punës. 2. Kriteret specifike mund të përcaktojnë kualifikimin, licencimin dhe/apo certifikimin e posaçëm që kërkohe për pozitën përkatëse.

-Nenin 21: Procedura dhe forma e përshkrimit të punës 1. Përshkrimi i punës është një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave kryesore dhe përgjegjësi kryesore të pozitës së punës. 2. Përshkrimi i punës shërben për: 2.1. të njohur nëpunësin civil me punën që duhet të kryejë; 2.2. vlerësimin dhe klasifikimin e pozicionit të punës; 2.3. vlerësimin e rezultateve në punë; 2.4. përcaktimin e kriterëve për çdo pozite pune në shërbimin civil. 3. Përshkrimet e vendeve të punës hartohen dhe ndryshohen kur krijohen institucionet e reja, kur ndryshon organizimi i brendshëm, zgjerohet mandati apo fushëveprimi apo shtohen detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit përkatës. 4. Përshkrimi i vendeve të punës hartohet nga Grupi i vlerësimit të klasifikimit, në bashkëpunim me mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të pozitës së punës. 5. Përshkrimi i vendeve të punës miratohet nga drejtuesi më i lartë administrativ i institucionit, pas pëlqimit nga DMZP, për institucionet e administratës shtetërore. Ndërsa institucionet tjera, mund të kërkojnë mendim këshillimor në DMZP para miratimit nga drejtuesi më i lartë administrativ i institucionit. 6. Përshkrimet e punës të miratuara si në paragrafin 7 të këtij neni, vendosen në SIMBNj nga NjMBNj e institucionit përkatës. 7. Përshkrimi i punës për pozitat e shërbimit civil bëhet sipas formës standarde të përcaktuar në Shtojcën Nr. 3, që është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Referuar kuadrit ligjor si më lartë, Kolegji i Këshillit thekson faktin e pa kontestuar së në varësi të natyrës, përgjegjësi dhe faktorëve të komplikimit të pozitës përkatëse të punës, mund të përcaktohen kritere specifike shtesë për këtë pozitë punës, çdo herë duke ndjekur kërkesat ligjore dhe procedurale të përcaktuara me ligj dhe akt nënligjor. Rrjedhimisht, në rastin konkret kërkesat e përgjithshme formale për pozitën e shpallur janë të përcaktuara me nenin 9 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, më të cilat dispozita parashihet se: *“2. Inspektorët e arsimit zgjedhën në pajtim me procedurat e Ligjit për Shërbimit Civil. Përveç kushteve të parapara me Ligjin për Shërbimin Civil, kandidatët duhet ti plotësojnë edhe këto kritere: 2.1. të kenë së paku titull master (300 ECTS); 2.2. të kenë të paktën pesë (5) vjet përvojë pune në arsim. 2.3. të mos ketë ushtruar funksione politike në tre (3) vitet e fundit”*.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimet ankimore referuar refuzimit të aplikacionit të ankuesit, ka analizuar dokumentacionin e dorëzuar nga ankuesi më rastin e aplikimit, i përcjell në Këshill përmes përgjigjes në ankesë, dhe si rrjedhojë e analizimit Kolegji ka gjetur së ankuesi përkitazi me dokumentet e kërkuar sipas klauzolës nr. 5 të konkursit, ka dorëzuar dokumentet e përgatitjes profesionale dhe të përvojës së punës, ndërsa lidhur me dëshminë që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rënda në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucione publike, **ankuesi si provë ka bashkangjitur** Vetëtimin 112/336/2023 të datës 24.07.2023, të lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Gjakovës, më të cilin vërtetohet së ankuesi ka qenë mësimdhënës në SHM. “Gjimnazi Dushi” dhe SHMLM “Hysni Zjani”, duke mos u specifikuar periudha e angazhimit dhe njëkohësisht sipas këtij dokumenti konfirmohet së ankuesi sa ka qenë i angazhuar në këto shkolla nuk ka pas në fuqi asnjë masë disiplinore dhe se i njëjti nuk është larguar nga puna si pasojë e masës disiplinore, rrjedhimisht sipas deklaratimeve të ankuesit në aplikacionin e datë 08.04.2024 ky angazhim ka qenë prej datës 15.10.2007 deri 22.12.2017. Andaj, duke qenë së Vërtetimi nr.112/336/2023 i datës 24.07.2023, i referohet vetëm periudhës sa ankuesi ka qenë i angazhuar në institucione publike, ndërsa, meqenëse ankuesi në aplikacionin e datës 08.04.2024 ka potencuar së i njëjti ka qenë i angazhuar në institucione jo publike si në Giz dhe OJQ “Nevo Koncept” në periudhën kohore 01.09.2017 deri 09.10.2019, në Shollën Private “The British School of Kosova” për periudhën nga data 02.09.2019 deri 30.06.2020 dhe në Shkollën “Milinumi i Tretë” Prishtinë, për periudhën 01.09.2021 deri me 30.06.2022, andaj, lidhur me këtë përvojë të punës në institucione jopublike ankuesi është dashur të dorëzojë vet deklarata ashtu siç ishte përcaktuar në pikën 5 të konkursit citojmë: *Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucione publike*. Mbi këtë bazë të konstatimi, rrjedhë së Njoftimi i datës 28.10.2024, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për refuzimin e aplikacionit, është në pajtim me nenin 39 paragrafi 7 nën paragrafi 7.1, të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me refuzimin e aplikacionit është i pabazuar.

Ndërlidhur më respektimin e parimit të meritokracisë si parim bazë për pranim në shërbimin civil, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar dosjen e kandidatëve fitues nga rrjedhë:

-Kandidatja M.D, posedon: Diplomën me Nr. 713 të datës 10.07.2014, për përfundimin e studimeve themelore më datë 26.02.2014, në Fakultetin e Edukimit, Programi Biologji-Kimi, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, duke marrë titullin Bachelor i Biologji-Kimi; Diplomën me Nr.526 të datës 02.10.2019, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, e sipas të cilës dëshmohet se kandidatja M. Doli, më datë 18.09.2018 ka përfunduar studimet master në Fakultetin e Edukimit duke

marr titullin Master i Edukimit-Mësimdhënie dhe Kurrikulë. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës në arsim kandidatja ko ofruar si dëshmi: Vërtetimin Nr. 58/24 të datës 08.04.2024, të lëshuar nga Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët “Fehmi Agani”, në Gjakovë, më të cilin vërtetohet së e njëjta është e angazhuar panë kësaj shkolle si mësimdhënësi në lëndën Kimi-Bilogji për periudhën 21.10.2002 deri më datë 23.03.2016, prej datës 24.03.2016 deri më datë 15.07.2021, ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Shkollës, ndërsa pas datës 16.07.2021, vazhdon në pozitën mësimdhënëse në lëndët Kimi-Biologji, pranë kësaj shkolle. Po ashtu si dëshmi ka të bashkangjitur Vërtetimin Nr. 57/24 të datës 08.04.2024, të lëshuar nga Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët “Fehmi Agani, më të cilin është vërtetuar së kandidatja nuk ka në fugi ndonjë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

-Kandidati N.P posedon: Diplomën me Nr. 227 të datës 02.09.2003, për përpunimin e studimeve themelore më datë 11.11.1999, në Fakultetin Filozofik, Universiteti i Prishtinës, duke marr titullin Profesor i Historisë; Diplomën Nr.18 të datës 25.04.2013, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, e sipas të cilës dëshmohej se më datë 10.04.2013, ka përfunduar studimet master në Fakultetin e Edukimit , duke marr titullin Master i Edukimit-Mësimdhënie dhe Kurrikulë. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës në arsim i njëjti posedon: Vërtetimin Nr. pr.01/861 të datës 23.11.2022, të lëshuar nga Drejtoresha e Shkollës së Mesme e Lartë Ekonomike “Kadri Kusari” në Gjakovë, më të cilin vërtetohet së kandidati ka qenë mësimdhënësi i edukatës qytetare pranë kësaj shkolle nga data 01.09.2012 deri më datë 31.09.2016 , ndërsa nga data 01.09.2018 vazhdon angazhimin e tij si mësimdhënësi pranë kësaj shkolle; Vërtetimin e datës 06.09.2018, të lëshuar nga MASH, sipas të cilit është konfirmuar së kandidati N.P përgjatë vitit 2010-2018 ka qenë i angazhuar në cilësinë e ekspertit për hartimin e dokumenteve kutikulave, programeve mësimore për lëndën e Historisë. Posedon edhe vërtetimin NJMNJ/246/2024, të datës 22.04.2024, të lëshuar nga Komuna e Gjakovës, më të cilin është vërtetuar së ndaj kandidatit nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë disiplinore, si dhe nuk ka ndonjë masë disiplinore në fuqi.

-Kandidati M.F, posedon: Diplomën me Nr.27 të datës 04.12.2008, për përfundimin e studimeve themelore më datë 26.09.2008, në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës duke marr titullin Baçelor i Gjeografisë-Edukatë Qytetare; Diplomën me Nr.503 të datës 23.09.2019, të lëshuar nga Fakulteti i Edukimit në Universitetin Aleksandër Moisiu në Republikën e Shqipërisë, për kryerjen e studimeve më datë 29.09.2015 në Master i Shkencave në Menaxhim dhe Supervizim i Institucioneve Arsimore, diplomë e njohur sipas Vendimit Ref.Nr.2/6-2258 të datës 19.05.2023 të MASHT. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës në arsim i njëjti sipas ka ofruar si dëshmi Vërtetimin më numër protokolli 2552/2024 të datës 22.04.2024, të lëshuar nga Sekretari i Shkollës Fillore e Mesme e Ulët “Emin Duraku “ në Gjakovë, më të cilin vërtetohet së kandidati që nga viti 2010 deri tani është në marrëdhënie punë në këtë shkollë si mësimdhënësi i rregullt. Posedon Vërtetimin më numër protokolli 2553/2024 të datës 22.04.2024, të lëshuar nga Sekretari i Shkollës Fillore e Mesme e Ulët “Emin Duraku “ në Gjakovë, më të cilin dëshmohej se nuk ka pasur asnjëherë masë disiplinore në fuqi.

-Kandidati A.H posedon: Diplomën me Nr.24 të datës 04.12.2008, për përfundimin e studimeve themelore më datë 14.07.2008, në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës, duke marr titullin Bachelor i Teknologjisë-Informatikës; Diplomën Nr.384/1214 të datës 01.12.2014, të lëshuar nga Kolegji FAMA, me të cilën dëshmohej se më datë 22.11.2014 , ka përfunduar studimet Master i Arteve në Banka, Financa dhe Kontabilitet. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës në arsim i njëjti posedon Vërtetimin Nr.04/1777 të datës 19.04.2024, të lëshuar nga Drejtori i Shkollës së Mesme e Lartë e Mjekësisë “Hysni Zjani”, në Gjakovë, sipas të cilit konfirmohet së kandidati nga data 07.06.2007 deri më datë 14.09.2008, ka qenë mësimdhënësi i Teknologjisë Informative në këtë shkollë, nga data 14.09.2008 vazhdon si Sekretar i shkollës. Lidhur me këtë angazhim, i njëjti ka ofruar dëshmi lidhur me masën disiplinore gjegjësisht Vërtetimin NJMBNJ/238/2024 të datës 17.04.2024, të lëshuar nga Komuna e Gjakovës, më

të cilin dëshmohet vërtetuar së ndaj kandidatit nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë disiplinore, si dhe nuk ka ndonjë masë disiplinore në fuqi

-Kandidatja A.L posedon: Diplomën me Nr. 108 të datës 20.07.2016 , për përfundimin e studimeve themelore më datë 16.02.2016, në Fakultetin Filologjik, Universiteti i Prishtinës “ Hasan Prishtina” duke marr titullin Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze; Diplomën me Nr.798/18 të datës 03.07.2018, të lëshuar nga Kolegji AAB, e sipas të cilës dëshmohet se më datë 03.07.2018, ka përfunduar studimet master në Gjuhë Angleze. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës në arsim e njëjta ka ofruar si dashi Vërtetimin Nr. protokolli 7010/2023 të datës 02.06.2023 të lëshuar nga Sekretari i Shkollës Filllore e Mesme e Ulët “Selman Riza” në Gjakovë dhe Vërtetimin NJMNJ/24682024, të datës 23.04.2024, të lëshuar nga Komuna e Gjakovës, me të cilin dëshmohet së e njëjta është e angazhuar si mësimdhënëse e gjuhës angleze në Shkollën Filllore të Mesme e Ulët “Selman Riza” dhe atë nga data 05.12.2017 e tuje, Ndërsa sipas Vërtetimit NJMNJ/24682024, të datës 23.04.2024, është vërtetuar së ndaj kandidatit nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë disiplinore, dhe nuk ka ndonjë masë të rëndë disiplinore në fuqi.

-Kandidatja A.K, posedon: Diplomën me Nr.443 të datës 20.08.2012, për përfundimin e studimeve themelore më datë 14.07.2010, në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës, duke marr titullin Bachelor i Programit Fillor; Certifikatën e datës 23.06.2014, të lëshuar nga Kolegji Biznesi me të cilën dëshmohet se më datë 23.06.2014, ka përfunduar studimet master në Menaxhement i Resurseve Njerëzore. Lidhur me përvojën e punës në arsim posedon Referencën Nr. prot.1/137 të datës 23.08.2012, të lëshuar nga Instituti Arsimor Privat Mehmet Akif College, më të cilin vërtetohet së nga shtator 2011 deri në qershor 2012 ka punuar si mësuese e programit fillor; Vërtetimin Nr. 64/24 të datës 15.04.2024 të lëshuar nga Shkolla Filllore Fehmi Agani, më të cilin vërtetohet se kandidatja nga data 21.09.2014 vazhdon të punoj si mësimdhënëse e mësimi klasor në këtë shkollë, e po ashtu më këtë dokument është dëshmuar se e njëjta nuk ka në fuqi ndonjë masë disiplinore për shkelje të rëndë disiplinore.

-Kolegji i Këshillit, bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, vlerëson se kandidatët fitues, M.D, N.P, M.F, A.H, dhe A.L kanë plotësuar kushtet e përgjithshme të konkursit dhe së të njëjtit me rastin e aplikimit kanë ofruar të gjitha dokumentet e kërkuara sipas pikës 5 të konkursit, e duke qenë së të njëjtit sipas vlerësimeve të testin me shkrim dhe intervistën me gojë kanë arritur të grumbullojnë edhe pikët e nevojshme për tu konsideruar kandidat të suksesshëm, atëherë, më të drejtë Njësia e Burimeve Njerëzore të organit të punësimit të njëjtit i ka shpallur si kandidat të suksesshëm në pajtim me nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ndërsa, Njësia e Personelit në fazën e verifikimit paraprak nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale duke e përfshirë kandidaten A.K si kandidat që ka plotësuar kriteret formale, sepse siç u sqarua si me sipër, kandidatja A.K, si dëshmi lidhur me kriterin e arsimit ka ofruar vetëm Diplomën me Nr.443 të datës 20.08.2012 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës e sipas të cilës dëshmohet se më datë 14.07.2010, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin e Edukimit duke marr titullin Bachelor i Programit Fillor, dhe Certifikatën e datës 23.06.2014 të lëshuar nga Kolegji Biznesi me të cilën dëshmohet se më datë 23.06.2014 ka përfunduar studimet master në Menaxhement dhe Financa, e që në vlerësimin e Kolegjit dhe ashtu siç është përcaktuar më klauzolën nr. 5 të Konkursit si dëshmi për të vërtetuar kriterin e arsimit në këtë rast studimeve master është përcaktuar diplomë. Rrjedhimisht, një konstatim të tillë Kolegji e mbështeti në faktin se sipas Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, kriteri i përgjithshëm formal

lidhur me arsimin dëshmohet përmes diplomës. Andaj, në mungesë të këtij dokumenti-diplomës, njësia përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me vet kriteret e përcaktuara me konkurs ku citojmë: 5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre:.... ***Kopjen e diplomës të kërkuar më konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës.....***

Ndërlidhur më respektimin e parimit të meritokracisë si parim bazë për pranim në shërbimin civil, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar dosjen e kandidatëve fitues nga rrjedhë:

-Kandidati B.P posedon Diplomën e datë 12.10.2013 me shifër Nr.2109 përmes së cilës dëshmohet se i njëjti ka mbaruar studimet themelore në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, si dhe po ashtu posedon Diplomën e datës 18.07.2019 me shifër Nr.942 përmes së cilës dëshmohet se i njëjti ka mbaruar studimet Master në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, ndërsa lidhur me përvojën e punës i njëjti posedon Vërtetimin Nr.83 të datës 30.04.2024 e lëshuar nga ShFMU “26 Marsi” përmes së cilit dëshmohet se i njëjti ka të themeluar marrëdhënien e punës në shkollën respektive që nga data 18.09.2015 dhe deri në momentin e lëshimit të vërtetimit përkatës, ka tetë (8) vite e shatë (7) muaj përvojë pune.

-Kandidati I.K, posedon Diplomën e datë 24.10.2008 me shifër Nr.12-654-04/966 përmes së cilës dëshmohet se i njëjti ka mbaruar studimet themelore në Fakultetin Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe ka marr titullin Jurist i Diplomuar, diplomë kjo e cila është e nostrifikuar përmes Vendimit të datës 21.01.2009 të Kryetarit të Komisionit Kombëtar për Njohje dhe U.D Sekretari i Përhershëm i MASHT-it, dhe po ashtu i njëjti posedon Diplomën e datës 24.03.2015 me shifër Nr.805 përmes së cilës dëshmohet se i njëjti ka mbaruar studimet Master në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, ndërsa lidhur me përvojën e punës i njëjti posedon Akt Emërimit e datës 01.01.2012 (i karrierës-pa afat) përmes së cilit konfirmohet fakti i si njëjti ka pasur të themeluar marrëdhënien e punës në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Komunën e Prizrenit në pozitën “Bashkëpunëtor Profesional”, ndërsa sipas Vërtetimit numër Reference:12/2021 të lëshuar nga Drejtori i Shkollës SHMLM “Lorenc Antoni” dëshmohet fakti se i njëjti nga data 02.10.2017 deri me datë 01.11.2021 në shkollën përkatëse ka mbajtur pozitën Administrator/Sekretar, dhe sipas Akt Emërimit AE.Nr.01-112-172224 të datës 29.10.2021, i njëjti që nda data 01.11.2021 mban pozitën “Zyrtar Ligjor 2” në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Komunën e Prizrenit, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit nuk është i bazuar pasi që të dy kandidatët e suksesshëm i kanë plotësuar kriteret e konkursit Nr. Reference: RN00013761, për grupin e arsimit, për pozitën “Inspektor i Arsimit-SIA Prizren”, të shpallur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologji me datë 05.04.2024, ndërsa është për tu theksuar fakti se në këtë konkurs nuk ka qenë kriter posedimi i Licencës së mësimdhënësit.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendi

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.83/2025

Sabile Avdyli

Procesëmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit S.A;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit ,Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit :dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së